REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Nr 1532/1 **Prot**

Fushë-Arrëz, më 05.06.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA FUSHË-ARRËZ SEKRETARIA

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e Projektvendimit nr. 14, datë 21.05.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për " Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024, per buxhetin e vitit 2025."

Analiza ligjore: Ky Projektvendim është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njesive te qeverisjes vendore ne Republikën e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "18"; neni "34", neni "40", neni "41", neni "54" germa "Dh", neni "55"pika 3, neni "64" germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni "4", neni "5" germat "a & ç", neni "6" germa "d",neni "7" pika "1", neni "21" pika "3", neni "23", neni "33", neni "39", neni "40", neni "41", Ligjit nr. 9936 date 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjit 10296, datê 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhezimit Vjetor nr. 3, datë 28/02/2024 "për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", Udhezimit nr. 23, datë 30/07/2018 "Për proçedurat standarte të pregatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njesive te vetëqeverisjes vendore", Udhezimit nr. 9, date 20/03/2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, si dhe Akt-rakordimit ndermjet Bashkise Fushë Arrëz dhe Degës së Thesarit Pukë për Transfertat dhe të ardhurat e trasheguara nga viti 2024.

Situata aktuale e funksionit:

Fondet e trashëguara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme në lekë:

Nr.	*Përshkrimi*	*Viti*
		2025
1	Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	30,748,190
Shuma 1		**30,748,190**
2	Të ardhura të trashëguara	23,755,217
Shuma 2		**23,755,217**
Totali 1+2		**54,503,407**

Situata financiare: Sipas Projektit te paraqitur nga Drejtoria e Finances, fondet e trashëguara ndahen: Transferta e pakushtezuar e trasheguar, 30,748,190 lekë; Te ardhura te trasheguara, 23,755,217 lekë: Totali 54,503,407 lekë

Drejtoria / Sektori përgjegjës:
Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimin dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Vendimi per " Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024 per buxhetin e vitit 2025" impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkise.

Komisioni i Përhershëm për " Ekonomi dhe Financë", i mbledhur me datën 05/06/2025, shqyrtoi projekvendimin nr. 14, datë 21.05.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për " Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024, per buxhetin e vitit 2025."

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
   b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Besjana Marku **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 1532 prot.

Fushë-Arrëz, më 05.06.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbikqyrjes Financiare Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi Projektvendimin për " Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024, per buxhetin e vitit 2025."

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mblodh sot më, 05.06.2025, Komisioni i Ekonomisë Finances Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit). Gjithashtu i pranishem ishte, Pergjegjesi i Finances Z.Dritan Lika, i cili dha shpjegime per projektin e mësipërm.

Pergjegjesi i finances Z.Dritan Lika, shpjegoi se Bashkia Fushë Arrëz ka trashëguar dhe fonde të papërdorura nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat dhe shtesa gjatë vitit 2024, të cilat nuk janë shpërndarë. Duke marrë parasysh kërkesat e grupit të menaxhimit strategjik si dhe duke ju referuar prioriteteve të miratuara, është parë e arsyshme që këto fonde të përdoren për rritjne e cilësisë së shërbimeve të ndryshme që Bashkia ofron si dhe investime të ndryshme.

Fondet e trashëguara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme në lekë:

Sipas Projektit te paraqitur nga Drejtoria e Finances, fondet e trashëguara ndahen: Transferta e pakushtezuar e trasheguar, 30,748,190 lekë; Te ardhura te trasheguara, 23,755,217 lekë: Totali 54,503,407 lekë.

Shuma prej 7,341,066 lekë është përdorur për plotësimin e nevojave për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2025. Shuma prej 1,100,000 lekë do të përdoret për shpenzime operative për të mbuluar shërbime të ndryshme që mbulohen nga ky program ekonomik. Shuma prej 176,200 do të përdoret për transferta tek individët për raste dalje në pension.

Shuma prej 1,000,000 lekë është përdorur për plotësimin e nevojave për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2025. Shuma prej 227,000 lekë do të përdoret për shpenzime operative për të shtuar vlerën për blerje kripe dhe granil për rrugët rurale.

Shuma prej 2,535,506 lekë është përdorur për plotësimin e nevojave për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2025 për të mbuluar shtesën prej 5 vende pune në këtë program. Shuma prej 7,583,500 lekë do të përdoret për shpenzime operative për të mbuluar disa shërbime shtesë në këtë program, të cilat janë Blerje boje printeri dhe fotokopje 600 mijë lekë, Veshëmbathje për punonjësit e shërbimeve 180 mijë lekë, pastrim rrugësh 2377 mijë lekë, Blerje materiale pune për shërbimet publike 1000 mijë lekë, Blerje inerte (Rerë, zhavorr etj) 1000 mijë lekë si dhe mirëmbatje fotokopje dhe printera në vlerën 270 mijë lekë, 300 mije leke per mirembajtje automjetesh, 500 mije leke blerje paleti te Kopshti e Çerdhja e femijeve. Në zërin 602, kapitulli 6, shuma prej 61 500 lekë është bashkëfinancim me UNDP. Sa i përket zërit të investimeve dhe projekteve, këto janë të detajuara në tabelen e investimeve

Shuma prej 794,000 lekë është përdorur për plotësimin e nevojave për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2025 për të mbuluar pjesën e bashkëfinancimit që Bashkia ka për këtë projekt sipas marrveshjes me Ministrinë përkatëse. Shuma prej 74,000 lekë do të përdoret për shpenzime operative për mbulimin e aktiviteteve që ka të planifikuara për vitin 2025.

Shuma prej 620,280 lekë është përdorur për bashkëfinancim për një projekt që Bashkia ka aplikuar për bonus strehimi, gjithashtu në zërin Investime vlera prej 1,769,400 lekë është bashkëfinancim për rikonstrukson të çative të pallateve të cilat plotësojnë kriteret për financim nga Ministria përkatëse.

Një pjese e konsiderueshme e fondeve të mësipërme janë planifikuar të përdoren për investime publike të cilat janë shpërndarë duke adresuar kërkesat e paraqitura gjatë periudhës së buxhetimit si dhe në përputhje të plotë me listen e objekteve prioritare.

Ne monitor shfaqen tabelat me te dhenat.

Pa diskutime te metejshme anetaret e komisionit rane dakord me shumice votash duke e derguar projektvendimin per shqyrtim te metejshem dhe miratim ne mbledhjen Plenare te dates 09.06.2025.

Duke kerkuar bashkepunimin tuaj!

PER KOMISIONIN:

Kryetar		**Sekretar**
Franc DODA	Zef Gjergj Lin!	**Besjana Marku**
	Valentin Dogi	